



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:135652

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06296485

C.nr.2149/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.S. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Sh. nga Prizreni, kundër të paditurve: R.P., D.Gj., S.Gj. me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë, S.S. nga Negotin, Republika e Serbisë dhe R.S. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë, jashtë seancë gjyqësore, më datë 15.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore sipas padisë së paditësit M.S. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, kundër të paditurve: R.P., D.Gj., S.Gj. me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë, S.S. nga Negotin, Republika e Serbisë dhe R.S. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë sipas propozimit të paditësit, kur ai shpreh interes dhe pushon shkakun e ndërprerjes.

A r s y e t i m

Paditësi M.S. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. B.Sh. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi, kundër të paditurve: R.P., D.Gj., S.Gj., me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë, S.S. nga Negotin, Republika e Serbisë dhe R.S. nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë.

Gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata ka gjetur se adresa e të paditurit S.S. është në Negotin, Republika e Serbisë. Po ashtu, edhe të paditurit: R.P., D.Gj., S.Gj. janë me vendbanim në Beograd, Republika e Serbisë, ndërsa lidhur me komunikimin me autoritetet serbe, deri ditën e këtij aktvendimi janë ndjekur kanalet diplomatike. Nga Ministria e Drejtësisë, si autoritet qendror për procesimin e kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare, është pranuar një përgjigje më datë 02.05.2023, të cilët kanë njoftuar se nga ana e autoriteteve serbe është ndërprerë njëanshëm bashkëpunimi juridik. Gjendur në këtë pozitë, nuk ekziston ndonjë mënyrë tjetër për të vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve procedurale, prandaj në kuptim të nenit 278 par. 1 pika b), gjykata vendosi të ndërpresë procedurën kontestimore. Ndonëse dispozita e cituar i referohet rrethanave që dërgojnë në ndërprerje pa fajin e gjykatës, por se me ngjarje që e bëjnë të pamundur punën në gjykatë, ndërprerja e komunikimit diplomatik, në një mënyrë është ngjarje jashtë veprimtarisë së gjykatës, e cila bën të pamundur zgjedhjen e ndonjë mënyrë tjetër të komunikimit.

Numri i lëndës: 2022:135652  
Datë: 15.10.2024  
Numri i dokumentit: 06296485

Me ndërprerjen e procedurës, nënkuptohet se për atë lëndë pushon aktiviteti procedural i gjykatës, mirëpo me propozimin e palës aktive në procedurë, mund të vazhdohet e njëjta, në qoftë se parashtron propozim për këtë gjë dhe kur eliminohen pengesat që rasti mund të përfundojë meritorisht.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 278 par. 1 pika b), nenit 387 par. 1 pika e) dhe nenit 142 të Ligjit për procedurën kontestimore.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil  
C.nr.2149/2022, datë 15.10.2024

Gj y q t a r i  
Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.